

DARKO CVIJETIQ

Lifti i Schindlerit

Roman

Përktheu: Qerim Ondozi

Shtëpia Botuese PA
Prishtinë 2022



Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritimit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zvicëran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S.Fischer.

PROLOG

Tapiceria nga muri në Michigan u pëshpërit plakave të
mira: Edhe pak, xhan, dhe do të më bëhesh trëndafili i
tetëdhjetë e tetë,
ai pak gjak
që mbetet pas çeljes. Po, isha me fat,
dhe nuk vdiqa për atdhe, tha,

Vetëm se,
Ai nuk e pati atë fat, dhe vdiq për mua, qeshte Shime dhe
tundte dorën nga kamioni.

Një vit më vonë, të vdekur do ta ndërronin, te Drvari, në
të nëntëdhjetegjashtën.

KREU I PARË – I CILI NUK E KA TREGUAR RRËFIMIN

1.

Brenda njerëzve që vrisnin, sikur brenda dhomës ku nuk troket kush, depërton lagështia.

Stemat mbi verëra, grumbuj putrash të çiftuara pa lënë gjurmë. Gjithçka laget.

Ai që krijon duhet të jetë edhe ai që do të shpëtojë, si dhe ai që do të shpaguajë gjithçka që ka krijuar.

Të bësh nuk mjafton, duhet shpëtuar të bërën.

Në fund të Hamletit, del Fortinbrasi.

Por, ai është djalosh, djalosh pa mjekër, i cili mban një grusht ushtarësh prej çeliku.

Horaci i afrohet dhe struket pranë tij.

Duhet treguar rrëfimin, por lëngu cerebrospinal në kafkë u pushtua nga batica.

Ai hesht.

Shkon lagështia të qërojë murin.

2.

Krahët i dridhen.

Meqë ka sadopak gjak në këpucë. E shikon qetas.

Zonja, duket, është e dehur.

Ka porositur – krahë dreri.

Kamerieri u kthye për një çast ... „Nuk kemi“.

3.

Çdo pardesy e ka braktisur babanë tim. Ngrohtësitë e Gajës, dorezat e nxehta të kopshtarit.

Troja është përplot kuaj cirku të braktisur.
Në raft, buzë shtratit, gjej fletoren e babait me orarin e
ndeshjeve të tenisit të Gjokoviqit.
Bretoni tha – vonë ke hyrë në këtë libër.

4.

Në filmin e Mishimas PATRIOTIZMI, para sepikut
(ritualit të harakirit), togeri Shingji dhe bashkëshortja e
tij e re, Reiko, çojnë dashuri.

Ajo ka marrë leje prej tij, me kërkesën e saj, që edhe ajo
të vrasë veten menjëherë pas tij.

E mbarësuar.

Herbarium gjithnjë i gërshetuar.

Me shpatën e samurajit çarçafi i lagur e i hekurosur.

5.

Paqja e Daytonit u nënshkrua atë natë. Ne nuk dinim gjë.
Nuk na lajmëruan.

Në mëngjes ata dolën nga istikamet, festojnë, ulërijnë,
shtien në ajër. Ne e shikojmë njëri-tjetrin të tmerruar.

Qetas dhe me përqendrim marr në nishan. E heq qafe më
të hareshmin.

Eh, ai.

Përnatë më vjen nga gardhi në kopsht.

Dhe këndon e s'ndalet, Zot i madh, thuajse nuk e kam
qëlluar.

KREU I DYTË

Me të nisur vendosjen në Soliterin e Kuq, në Prijedor, në pranverën e hershme të vitit, 1975 një grumbull i madh kalamajsh ulërinin në livadhin midis dy soliterëve, dy ndërtesa minatorësh. Bënin dordolecin katër metra të lartë, nga mbetjet e ndyra të saj.

Pesë vjet më vonë, pas vdekjes së Titos, njëherë e bënë Titon prej kartoni (duke imituar atë Titon që e panë në ekskursionin në Kumrovec), dhe të gjithë me radhë hëngrën dajak prej prindërve. Titoja ishte nga kartoni, me ngjitës, dhe era e mori shpejt dhe ra në bahçen e Taibit, mu bri soliterit.

Taibi ishte, siç dukej, përherë i vetëm dhe plak. Shtëpizën me oborr nuk e shiste për asnjë para të kësaj bote. Ngjitur me shtëpinë e tij nisën ta ndërtonin soliterin, dhe ishin të gatshëm ta paguanin të zhvendosej dhe ta prishte shtëpinë, mirëpo Taibi as që donte t'ia dinte. Vogëlushen, vajzën e tij, ia kishte mbytur me veturë komshiu i parë, Hamdija Kurtoviqi, pronari i dyqanit automekanik matanë shtëpizës së Taibit. Pa dashje, nja dhjetë metra më larg.

Taibi, pra, nuk donte ta prishte shtëpinë dhe të largohej nga vendi i rënies së fëmijës së tij. Me Hamdinë nuk fliste, e megjithëse Hamdiu disa herë i erdhi te dera. As që ia hapi.

Dhe të gjithëve u dhimbsej ky Taibi i pafat, i kërrusur. Edhe e shoqja i vdiq nga mërzia për të bijën, e Taibi i vetëm, me shtëpizën dhe mollën përpara, zhytej në vetmi, si në ujën e turbullt. Punonte me ditë të tëra në bahçe, prej nga edhe e shihte se si Hamdi Kurtoviqit po i rritej i biri, Amiri.

Titoja nga kartoni kalbej nën mollën e Taibit.

Pastaj, mu para lufte, Amirin e Hamdiut e mbyt infarkti në moshën njëzetetëvjeçare, në mes të kafenesë.

Nuk e di në i kishte shkuar mendja Taibit te Hamdi Kurtoviqi, e t'i thoshte: tash jemi baras. Me gjasë jo.

Në ditët e para të luftës, një natë futen hajdutët e maskuar, dhe e mbysin Hamdi Kurtoviqin dhe të shoqen, si dhe e plaçkitin dyqanin automekanik. Taibin nuk e ngucën, që ndodhej fill matanë rrugës, edhe pse ishte zor të thuhej se nuk e dinin që brenda ishte një boshnjak – me më shumë gjasë kujtonin se brenda ishte një boshnjak i varfër të cilin s'ia vlente as ta vrisnin. Taibi ishte prapa perdes. Dridhej. Mendonte. Mendonte edhe të falej, mirëpo nuk dinte se si. Kishte harruar. Zotit nuk i drejtohej që nga vdekja e fëmijës.

I mbytën, i mbytën, përsëriste në vete. E gjetën pas dhjetë ditësh.

I mbështjellë, sikur të kishte ndërmend të falej, por u mboll i vdekur me kokën poshtë dhe mbeti ashtu. Nuk arriti të merrte vesh Taibi nëse Hamdi Kurtoviqin dhe të shoqen e tij e kishte vrarë polici nga hetimi i vendit kur dikur moti u mbyt një vogëlushe me veturë.

Tash ka mbetur vetëm molla e kalbur.

Po ta shikoje me ngulm, do ta çoje nga toka edhe Titon nga kartoni e të kalbur bashkë me të.

E mbase ai po e mban Soliterin e Kuq mos të shembet mbi bahçen e Taibit, tani të pashtëpi, të pafëmijë dhe të zbrazët.

KREU I TRETË

Të gjithë banorët e parë i kujtojnë me kënaqësi agimet e 1 Majit, dhe a capellën e minatorëve të Lubisë, që me autobusin e minatorëve u soll përpara Soliterit të Kuq dhe atij të Kaltër, dhe për nder të Festës së Punës luante marshe, Internacionalen, këngë partizanësh dhe punëtorësh në agimin e hershëm, duke e zgjuar klasën punëtore.

Dhe komshinjtë zbrisnin, sillnin raki e ëmbëlsira, këndonin të përçafuar së bashku para shkuarjes në piknik në rrethinat e qytetit. Ashtu dikur.

Kështu sot:

Në agim presin pemën e kërshtëndellave. Dhe para kërshtëndellave sjellin degën e lisit. Dhe populli zbret nga ndërtesa, dhe këndon ojkaça, ndez zjarrin dhe zien çorbën, dhe shtien e pi raki për nder të Lindjes së Shpëtimtarit.

E të gjithë i ruan marica e policisë nja pesëmbëdhjetë metra larg, brenda së cilës rrinë pesë pjesëtarë të maskuar dhe të armatosur të njësitit special, pesë pjesëtarë të njësitit antiterrorist. Në soliter tash jetojnë pesë familje boshnjake dhe pesë forca speciale, mbase e ruajnë degën e kërshtëndellave prej tyre, për ditëlindjen e Jezusit.

KREU I KATËRT

Adem Qordiqi jetonte me familjen së pari në të katërtin, e pastaj në katin e nëntë. Inxhinier në minierë, baba i dy vajzave, njeri i hareshëm, i qetë, oficer rezervist i APJ-së.

Atë ditë kur lufta hyri në soliterin 101 (i quajtur Soliteri i Kuq), ushtarët serbë që e bastisën soliterin e mbytën Ademin në kolltuk, në katin e nëntë. Ia kishin gjetur uniformën (e ç’duhet të gjenin – rekuizitat e baletit të një balerini rezervist?), dhe me rafal e prenë derisa rrinte ulur. E nxorën me lift të Schindlerit, e tërhoqën zvarrë në rrugë, si qenin që lë gjurmë të përgjakur, dhe e lanë në kopshtin e Taibit.

Që atëherë, sa e sa kishin jetuar në banesën e familjes Qordiq.

E pastaj, nga fillimi i shekullit XXI, në atë banesë u vendos një grua e mbështjellë, e cila e bleu banesën me kesh. Krejt e mbështjellë, myslimane, vetëm me një vrimë për sy, e vetme.

Në soliter i shmangen të gjithë, i pëshpëritin pas shpine, frikësohen, dhe askush nuk guxon të futet me të në lift të Schindlerit.

Një herë erdhi postieri.

Pyeti komshiun Ili Srediqin, nga kati i shtatë, në e dinte se ku banonte Adem Qordiqi?

E ç’të duhet, pashë besën, ia ktheu me pyetje Ilija Srediqi, gazetar i gazetës së brendshme të minatorëve.

„Ka vërejtje nga gjykata, nuk ka paguar, për vite të tëra, tatimin në pronë”, thotë qetas postieri.

A e di ti, or burrë, i tha Ili postierit, se Adem Qordiqi fatkeq u vra në kampin Omarska, dhe se kurrë nuk ia gjetën eshtrat në tokë?

Postieri në fillim heshti, mbase një minutë më gjatë se zakonisht:

A je ti i sigurt, Ili, i tha me pëshpërimë, se ajo grua e mbështjellë nga i nënti, në banesën e dikurshme të Ademit – nuk është ai?

„Tatimi në tokë është tatimi në tokë, edhe nëse nuk të gjejnë në të.”